

## Kids Athletics Kashar 18.12.2015

Ne daten 18 Dhjetor 2015 Federata Shqiptare e Atletikes, ne bashkepunim me Qendren Administrative Kashar dhe Drejtorine Arsimore Rajonale, ne prani edhe te mediave vizive dhe te shkruara si TVSH dhe Top Channel, zhvilloi aktivitetin promovues te atletikes per femije, Kids Athletics ne Kashar. Federata Shqiptare mundesoi nje set me pajisjet e Kids Athletics, te ardhura nga IAAF per promovimin e atletikes ne Shqiperi , per zhvillimin e ketij aktiviteti dhe ne fund te aktivitetit ja dhuroi kete set Qendres Administrative Kashar, me qellim zhvillimin dhe promovimin e metejshem te atletikes. Sic mund te shihet edhe ne programin e bashkengjitur ne linkun e meposhtem, ne kete aktivitet moren pjese 9 shkolla :”Shkolla 9 vjecare Yzberisht”,”Shkolla 9 vjecare Mzez Koder”,”Shkolla 9 vjecare Mzez Fushe”,”Shkolla 9 vjecare Yrshek”, “Shkolla 9 vjecare Kashar Koder”, “Shkolla 9 vjecare Kus”, “Shkolla e mesme Yzberisht”, “Shkolla Sadik Stavileci” dhe “ShMB Kashar”. Nderuan aktivitetin me pjesmarjen e tyre dhe drejtues lokal dhe perfaqesues nga MAS, Drejtoria e Sportit. Me poshte mund te shihni edhe disa foto:

